

TË DREJTAT E GRAVE

SHIKIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NGA PERSPEKTIVA E NDIESHME

GJINORE

FUQIZIMI I GRAVE

>>Përparimi i grave dhe arritja e barazisë mes grave dhe burrave është çështje e të drejtave të njeriut dhe kusht për drejtësinë sociale, dhe nuk duhet të mbahen të izoluar si probleme të grave.<<

DEKLARATA DHE PLATFORMA PËR VEPRIM E PEKINIT

TREGIMI ILUSTRUES

Rast i vërtetë: Tregimi i Maria da Pena Maja Fernandez (Maria da Penha Maia Fernandes).

Më 29 maj të vitit 1983, Maria da Pena Maja Fernandez, u qëllua me armë deri sa ishte duke fjetur, nga bashkëshorti i saj Marco Antonio Heredia Viveiros. Edhe pse mori lëndime të rënda, si dhe trauma fizike, psikike dhe paraplegji të përhershme, për fat të mirë ajo mbijetoi. Bashkëshortri i saj, i cili tentoi të mbulonte sulmin e tij të parë duke e raportuar atë si tentim të plaçkitjes, vetëm dy javë pasi që bashkëshortja e tij ishte lëshuar nga spitali, tentoi ta mbyste atë me rrymë deri sa ajo ishte dukë bërë banjë. Pas këtij sulmi të dytë, Zyra e Prokuroti Publik ngriti aktakuzë kundër Z.Viveiros. Gjykatës së Parë të Qarkut iu deshën tetë vjet që të vendosë për rastin. Më 4 maj të vitit 1991, juria e gjeti Z.Viveiros fajtor për sulm dhe tentim vrasje dhe e dënoi atë me 10 vjete burg. Pas ankesës, gjykimi i dytë u mbajt në vitin 1996, ku Z.Viveiros u dënua me burgim prej 10 vjet e gjashtë muajsh. Mbrojtja e tij parashtrroi ankesë të re dhe që atëherë, në mënyrë të vazhdueshme janë paraqitur fakte të reja dhe si rezultat i ngadalshmërisë së sistemit gjyqësor, nuk është arritur një vendim përfundimtar për këtë krim. Më 20 gusht të vitit 1998, Maria de Pena Maja Fernandez, Qendra për Drejtësi dhe të Drejtë Ndërkombëtare (CEJIL) dhe Komiteti Latino-Amerikan dhe Karaibik për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave (CLADEM), i parashtruan ankesë Komisionit Interamerikan për të Drejtat e Njeriut, duke pretenduar se Republika Federative e Brazilit ka dështuar për më se 15 vjet të ndërmarrë masa efektive për ndjekjen dhe dënimin e Z. Viveiros. Ankuesit, përveç argumentimit për shkëlqje të Nenit 1, paragrafi 1 (obligimi për të respektuar të drejtat),

Nenit 8 (e drejta për gjykim të drejtë), Nenit 23 (e drejta për mbrojtje të barabartë) dhe Nenit 25 (e drejta për mbrojtje gjyqësore) të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me Nenin 2 dhe 18 të Deklaratës Amerikane për të Drejtat dhe Detyrimet e Njeriut, gjithashtu pretendonin për shkelje të Neneve 3 dhe 4 të Konventës Interamerikane për Prandalimin, Dënimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës ndaj Grave dhe Neneve 5 dhe 7 të Konventës së rëndësishme të Belem do Paros (Belém do Pará). Sikurse edhe në rastet tjera, Shteti i Brazilit nuk e komentoi këtë ankesë. Në raportin e 16 prillit të vitit 2001, Komisioni Iner-Amerikan vendosi që Brazili kishte shkelur të drejtën e Maria de Pena Maja Fernandez për gjykim të drejtë dhe mbrojtje gjyqësore. Për më tepër, Komisioni vendosi që Brazili kishte shkelur edhe Nenin 7 të Konventës së Belém do Parós. Si rezultat i këtij raporti, në vitin 2002, gati 20 vjet pas tentimi të parë për ta vrarë gruan e tij, Z.Viveiros u arrestua dhe u dënua me burg.

BURIMI:

INTER-AMERICAN COMMISSION ON HUMAN RIGHTS – ORGANIZATION OF AMERICAN STATES. 2001. REPORT No 54/01, CSE 12.051, MARIA DA PENHA MAIA FERNANDES – BRASIL, 16 APRIL 2001, AVAILABLE ONLINE AT: [HTTP://WWW.CIH.OAS.ORG/ANNUALREP/2000ENG/CHAPERTIII/MERITS/BRAZIL12.051.HTM](http://www.cih.oas.org/annualrep/2000eng/chapterIII/merits/brazil12.051.htm)

PYETJET PËR DISKUTIM



1. Cilat janë problemet kryesore që ngriten nga ky rast?
2. Si mund të arrihet drejtësia, kur qasja ndaj gjyqeve dhe zhvillimi i gjykimeve të drejta janë në rrezik, për shkak të gjinisë së viktimës?
3. A mjaftojnë ligjet dhe rregulloret për të garantuar mundësitë e barabarta për të gjithë njerëzit?
4. A mund të parandalohen veprimet e ngjashme? Përmend mekanizma e nivelit lokal, regjional dhe ndërkombëtar që mund të përdoren për ta arritur këtë.

E DOMOSDOSHME TË DIHET



1. TË DREJTAT E GRAVE

Gratë kanë qenë të detyruara që për një kohë të gjatë të luftojnë për njohjen dhe pranimin e tyre si qenie të plota njerëzore dhe pranimin e të drejtave të tyre themelore, por fatkeqësisht, kjo luftë ende nuk ka përfunduar. Edhe pse situata e tyre është përmirësuar në shumë sfera në mënyrë globale, strukturat shoqërore dhe paragjykimet janë ato që ende po pengojnë implementimin e plotë dhe të menjëhershëm të të drejtave të grave. Shekulli i XX-të ka sjellë shumë përmirësime dhe keqësime, por edhe gjatë kësaj kohe të paqes dhe përparimit, grave dhe të drejtave të tyre nuk u është kushtuar ndonjë vëmendje e posaçme. Sidoqoftë, në të gjitha periudhat e historisë, mund të gjenden heroina të cilat kanë luftuar për të drejtat e tyre, qoftë me armë ose me fjalë. Për shembull, Ellenor Ruzvellt (Eleanor Roosevelt), insistonte që në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të vitin 1948, në Nenin 1 të draftit, në vend të “të gjithë njerëzit janë vëllezër”, të përdoret “të gjitha qeniet njerëzore janë të barabarta”. Ndryshimi i tillë në këtë formulim bëri të qartë se të drejtat e njeriut u takojnë të gjitha qenieve njerëzore, pa marrë parasysh nëse janë femra apo meshkuj dhe kjo bëri që barazia të jetë një ndër parimet fundamentale të të drejtave të njeriut.

Parimi i barazisë duke mos bërë diferencimin mes grave dhe burrave, ashtu si gjendet formalisht në ligj, shpesh në mënyrë të fshehtë nënkupton diskriminim ndaj grave. Duke pasur parasysh pozitat dhe rolet e ndryshme që kanë gratë dhe burrat në shoqëri, shpesh barazia “de iure” rezulton në diskriminim “de facto”. Kjo gjendje ka detyruar aktivistët e të drejtave të grave të promovojnë diferencimin (dallimin) mes barazisë formale dhe reale.

Në shumë raste, nocionet formale për barazinë të bazuara mbi hipotezat e barazisë ndërmjet të gjitha qenieve njerëzore, nuk u kanë ndihmuar njerëzve nëpër situata jo të favorshme. Nocioni i tillë duhet lëvizur drejt definimit real të barazisë, duke marrë parasysh pluralizmin, dallimet, disavantazhin dhe diskriminimin. Sikurse Dairijan Shanti (Dairian Shanti) thekson në artikullin e saj “Barazia dhe Struktura e Diskriminimit”, “neutraliteti nuk lejon që ndieshmëria të dëmtojë dhe me këtë të parandalojë disa njerëz të përfitojnë nga trajtimi i barabartë. Prandaj përqendrimi duhet të orientohet drejt potencimit të `rezultateve të barabarta` dhe `përfitimeve të barabarta`”. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave mund të arrihet vetëm nëse së bashku realizohen plotësisht barazia formale dhe ajo reale.

>>Gjatë mileniumit të ardhshëm do të bëhet përkthimi (transformimi) i forcës së numravë në forcën e veprimit për gratë, nga gratë dhe në partneritet me burrat.<<

AZZA KARAM

Gjinia dhe zgjerimi i koncepti të gabuar për të drejtat e grave

Gjinia është një koncept që nuk adreson vetëm gratë dhe të drejtat e tyre, por është një koncept më kompleks, me që përfshinë si burrat ashtu edhe gratë. Për herë të parë është përdorur në vitet e '70-ta nga Suzan Moller (Susan Moller) dhe është definuar si “*institucionalizim i thellë i fshehjes së dallimeve seksuale që përshkojnë shoqërinë tonë,*” dhe pastaj në gjithë botën u zhvillua si rezultat i zhvillimeve dinamike politike, shoqërore dhe transformimeve ekonomike. Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale i vitit 1998, pas një diskutimi intensiv mes përfaqësuesve të shteteve lidhur me përmbajtjen dhe konceptin e gjinisë, ku disa kundërshtonin zgjerimin e saj në orientim seksual, definoi gjininë si “dy sekse, mashkull dhe femër, përbrenda kontekstit të shoqërisë. . .”.

Megjithatë, në vend se gratë të pranohen si gjysma e popullatë botërore, gjysma e popullsisë së çdo vendi, të çdo populli autokton dhe shumë komuniteteve, është shumë e zakonshme të shihen definicion për gra si grupe të veçanta. Ky lloj koncepti mund të gjindet nëpër dokumente në të cilat gratë vendosen në paragrafe ose kapituj bashkë me grupet e tjera të rrezikuara, siç janë popujt autoktonë, të moshuarit, njerëzit me aftësi të ndryshme dhe fëmijët. Ajo që i lidh të gjitha këto grupe të rrezikuara, është fakti se të gjithë ata kanë përjetuar dhe ende përjetojnë diskriminim, si dhe nuk kanë mundur dhe ende nuk mund të gëzojnë në tërësi të drejtat e tyre elementare.

Sidoqoftë, gjinia është një kategori e dobishme për t'u analizuar, që neve na ndihmon të kuptojmë se si gratë dhe burrat në shoqëri marrin përgjegjësi, role dhe pozita të ndryshme. Përfshirja e analizave gjinore në teorinë dhe praktikën e të drejtave të njeriut, na bën ne të ndieshëm në veçanti ndaj dallimeve mes grave dhe burrave në shoqëri dhe për mënyrat specifike të shkeljes së të drejtave të grave.

Prandaj, është e qartë se duhet promovuar opinionin për ndieshmërinë-gjinore, me qëllim të arritjes së të drejtave të barabarta për të gjithë, pa dallim gjinie, ngjyre, race dhe religjioni.

Siguria njerëzore dhe gratë

Deri sa konfliktet ekzistuese po keqësojnë gjendjen e pabarazisë dhe diferencimit, **siguria njerëzore dhe statusi i grave**, janë të lidhura ngusht mes vete. Një vëmendje e veçantë dhe mbrojtje e posaçme u duhet kushtuar refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, shumica e të cilëve janë gra, të moshuar dhe fëmijë .

Siguria njerëzore ka të bëjë gjithashtu me sigurimin e qasjes së barabartë dhe për të gjithë njësor ndaj arsimimit, shërbimeve sociale dhe punësimit edhe gjatë kohës së paqes. Grave shpesh u mohohet qasja e plotë në këto fusha. Prandaj, gratë dhe fëmijët në veçanti janë përfitues të qasjes së sigurisë njerëzore nga perspektiva e të drejtave të njeriut, e cila dëshmon se nuk mund të arrihet kurrfarë sigurie njerëzore nëse nuk respektohen të drejtat e njeriut në tërësi. Kështu që, çrënjosja e çfarëdo forme të diskriminimit, në veçanti ndaj grave dhe fëmijëve, do duhej të ishte prioritet i agjendës së sigurisë njerëzore.

Për sigurinë njerëzore, një rëndësi të veçantë ka gjendja e grave gjatë konflikteve të armoatosura, që do të diskutohet më poshtë.

2. DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES



Për t'u kuptuar më mirë kërkesat e sotme të grave për të drejtat e tyre është i dobishëm shqyrtimi i historikut të lëvizjeve për të drejtat e grave.

Një vështrim historik

Revolucioni francez, si një ngjarje e rëndësishme historike, paraqet fillimin e përpjekjeve të femrave për t'u njohur në botën e meshkujve si qenie njerëzore të barabarta. Kjo epokë nuk paraqet vetëm fillimin e lëvizjes për të drejta civile dhe politike, por gjithashtu kjo kohë i shtroi rrugën lëvizjes së parë të grave për liri dhe barazi. Njëra nga shtytëset më të famshme të kësaj lëvizje ishte, Olimp de Guzh (Olympe de Gouges), e cila ka shkruar Deklaratën për të Drejtat e Gruas dhe Qytetarës Femër. Ajo, sikurse edhe shumë bashkëmendimtare të saj femra, e kanë paguar me gijotinë përkushtimin e tyre.

“Gruaja lind e lirë dhe gëzon të drejta të barabarta më mashkullin në çdo aspekt.”

Neni 1 i Deklaratës për të Drejtat e Gruas dhe Qytetares Femër, 1798.

Edhe Britania e Madhe ka një traditë të vjetër dhe të fortë të luftës së femrave për të drejta të barabarta. Britania e Madhe shpesh quhet edhe “atdheu i feminizmit”. Qysh në vitet e 1830-ta, gratë britaneze filluan të kërkojnë të drejtën e votës. Ato luftuan për më shumë se 70 vite për ndryshimin e këtyre metodave, për të pasur sukses përfundimisht në vitin 1918, kur grave duke filluar në moshën 30 vjeçare iu dha e drejta për të votuar. Fushat e tjera të veprimit të tyre kanë përfshirë qasjen në arsimim, të drejtat e grave të martuara në pronë dhe të drejtën për të mbajtur pozita publike.

Gratë sidomos në Britani të Madhe dhe Shtete të Bashkuara të Amerikës kanë përdorur edhe metoda radikale, madje edhe greva të urisë. Sufragjeta (partizane e të drejtave të grave në Angli) e njohur Emilli Devjison (Emily Davison), gjatë një gare në vitin 1913 zgjodhi vdekjen me qëllim duke e hedhur veten para kalit të Mbretit Xhorxhi i V-të.

Këshilli Ndërkombëtar i Grave, i cili u themelua në vitin 1888, ekziston edhe sot. Ky Këshill ka selinë në Paris dhe merr pjesë aktive për të siguruar të drejtat e grave përmes takimeve ndërkombëtare, seminareve dhe workshopeve ndëregjionale dhe vendore, pastaj programeve intensive për zhvillim të projekteve në bashkëpunim me agjencionet ndërkombëtare, rezolutave të përpiluara dhe të miratuara në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, si dhe përmes bashkëpunimit në të gjitha nivelet me organizatat e tjera joqeveritare dhe planit trevjeçar të veprimit në secilin nga pesë Komitetet e tij të përhershme..

Organi i parë ndërqeveritar i cili ka trajtuar të drejtat e grave është Komisioni Interamerikan i Grave (CIM) për Regjionin e Amerikës Latine i cili është krijuar në vitin 1928. Ky organ ka qenë përgjegjës për përpilimin e Konventës Interamerikane të Grave, të miratuar nga Organizata e Shteteve Amerikane (OAS) në vitin 1933. Kjo konventë nxiti debat pasi që regjioni po zhvillonte një trup të ligjeve që do të trajtonte të drejtat e njeriut.

Qysh në vitin 1945, pra nga fillet e hershme të Kombeve të Bashkuara, gratë kishin tentuar të marrin pjesë brenda strukturës së saj dhe të bënin prezencën e tyre të dukshme

në përmbajtjen dhe implementimin e instrumenteve dhe mekanizmave për të drejtat e njeriut.

Komisioni për Statusin e Grave (CSW), i cili ka mandatin për promovimin e të drejtave të grave në gjithë botën, u krijua në vitin 1946. Kryesuesja e parë e tij ishte Bogil Boegstrup nga Belgjika. CSW-ja promovoi përfshirjen eksplicite të të drejtave të grave në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut.

Edhe pse gratë që nga fillimi kontribuan në mënyrë të barabartë evolucionin e sistemit ndërkombëtar politik, ekonomik dhe social, vëmendja ndaj problemeve të tyre ka qenë minimale. Dekada të tëra të verbërisë gjinore në dokumente për të drejtat e njeriut, kanë bërë që edhe njerëzit të verbërohen për këto fakte. Të drejtat fundamentale të më shumë se gjysmës së njerëzimit u harruan, gjë që sjell domosdo deri te konkluzioni se deri sa shoqëritë nëpër gjithë botën ende nuk janë neutrale ndaj gjinive dhe vazhdojnë të diskriminojnë gratë, nuk mund të ekzistojë neutralitet gjinor në ligje ndërkombëtare dhe vendore.

Pabarazia në shumë fusha të jetës së përditshme, pastaj varfëria në mesin e grave dhe diskriminimi ndaj fëmijëve vajza ishin ato rrethana që shtynë Kombet e Bashkuara që gjatë viteve të 1970-ta, të vendosin për lansimin e **Dekadës së Kombeve të Bashkuara për Gratë: Barazia, Zhvillimi dhe Paqja**, nga viti 1976 der më 1985. Në vitin 1979, me miratimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Dekada arriti kulminacionin. Kjo Konventë është instrumenti më i rëndësishëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave. Për herë të parë, CEDAW, i cili në vete përmban të drejta civile, politike dhe ekonomike, sociale e kulturore, duke bashkuar kështu dy kategori të të drejtave, të cilat përndryshe janë të ndara në dy kategori, njohu gratë si qenie të plota njerëzore.



“Diskriminimi ndaj grave nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim të bazuar në gjini, që ka për efekt ose qëllim të kompromitojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, cilado qoftë gjendje e tyre martesore, mbi bazën e

barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër.”

NENI 1 i KONVENTËS PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE CEDAW-it.

Përveç kësaj, CEDAW-i gjithashtu obligon shtetet anëtare:

- Të përfshijnë në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme parimin e barazisë mes grave dhe burrave;
- Të sigurojnë zbatimin efektiv të parimit të barazisë;
- Të miratojnë masa ligjore dhe masa të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe sanksione nëse është nevoja, për ndaljen e çdo diskriminimi ndaj grave;
- Të vendosin baza të barabarta për mbrojtje e të drejtave të grave dhe burrave;
- Të mos ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të arrijnë që autoritetet publike dhe institucionet publike t'i përmbahen këtij detyrimi;
- Të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin të cilin e ushtron ndonjë person, organizatë ose çfarëdo ndërmarrje ndaj grave;
- Të anulojnë të gjitha dispozitat penale që përbëjnë ndonjë diskriminim ndaj grave;
- Të sigurojnë zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave mbi bazat e barazisë me burrat, me qëllim që t'u garantojnë atyre në mënyrë të barabartë ushqimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut e të lirive themelore;
- Të ndryshojnë skemat dhe modelet sociale e kulturore të sjelljes së burrit dhe gruas;
- Të arrijnë zhdukjen e paragjykimeve dhe çfarëdo praktike tjetër zakonore, që mbështetet në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njerës apo tjetrës gjini, ose stereotipe të rolit të burrit dhe gruas;
- Të sigurojnë që edukimi familjar të përfshijë kuptimin e drejtë të maternitetit si funksion social dhe njohjen e përgjegjësisë së përbashkët të burrit dhe të gruas për përkujdesjen ndaj rritjes së fëmijëve dhe zhvillimit e tyre, duke bërë të qartë se kusht parësor në të gjitha rastet është interesi i fëmijëve;
- Të marrin gjitha masat e përshtatshme për të zhdukur të gjitha format e trafikimit të grave dhe ndalimin e prostitucionit të grave.

- Të sigurojnë votimin e grave në të gjitha zgjedhjet dhe referendumat publike, si dhe mes tjerash të jenë të zgjedhshme në të gjitha këto organe;
- T'u japin grave të drejta të barabarta me burrat në fushën e marrjes, ndërrimit dhe mbajtjes së shtetësisë;
- T'u sigurojnë grave të drejta të barabarta me burrat në fushën e arsimimit.

Konventa rregullon çështjet nga jeta private edhe ajo publike e grave. Disa dispozita kanë të bëjnë me rolin e grave në familje dhe shoqëri, nevojën për ndarjen e përgjegjësisë brenda familjes dhe nevojën urgjente për implementimin e ndryshimeve në sistemet sociale dhe kulturore, të cilat i atribuohen pozitës subordinuese të grave. Njohja e të drejtave të grave në nivel global mund të bëhet vetëm përmes këtyre ndryshimeve themelore. Kur një shtet bëhet palë e CEDAW-it, ai obligohet që me të gjitha mjetet e nevojshme dhe pa kurrfarë vonese ta respektojë politikën e eliminimit të diskriminimit dhe çdo akti tjetër diskriminues ndaj grave.

Më 6 tetor të vitit 1999, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me një vendim historik për gratë, të bazuar në konsensus, miratoi **Protokolin Opcional të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave** me 21 nene dhe u bëri thirrje të gjitha shteteve palë të Konventës, të bëhen sa më parë palë edhe të këtij instrumenti. Ky Protokol ofron mundësinë që Komisionit t'i adresohen ankesa individuale të bazuara në CEDAW. Deri në prill të vitit 2003 Protokolin Opcional, e kanë nënshkruar 75 shtete, deri sa tashmë e kanë ratifikuar 50 shtete.

BURIMI:

[HTTP://WWW.UN.ORG/WOMENWATCH/DAW/CEDAW/SIGOP.HTM](http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/sigop.htm)



Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut e mbajtur në Vjenë, në qershor të vitit 1993, mbledhi mijëra aktivistë dhe ekspertë për të drejtat e njeriut. **Deklarata dhe Programi për Veprim e Vjenës**, e miratuar si rezultat i kësaj Konference, vë theksin te promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të grave dhe të vajzave në përgjithësi dhe parandalimin e dhunës ndaj grave. Gjithashtu, deklaroi se pjesëmarrja e plotë dhe e barabartë e grave në jetën politike, civile, ekonomike, sociale dhe kulturore në

nivel vendor, regional dhe ndërkombëtar, si dhe çrënjosja e të gjitha formave të diskriminimit të bazuar në gjini, janë objektiva prioritare të bashkësisë ndërkombëtare.

Komisioni mbi Statusin e Grave, në kuadër të mandatit të tij ka organizuar katër **konferenca globale** kryesore, me qëllim të drejtave të grave si të drejta të njeriut, të bëhen tradicionale:

- Meksikë, 1975
- Kopenhagë, 1980
- Najrobi, 1985
- Pekin, 1995

Për më tepër, në New York në vitin 2000, u mbledh Takimi i 23-të Special i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, “*Gratë 2000: Barazia Gjinore, Zhvillimi dhe Paqja në shekullin XXI*”, me qëllim të vlerësimit të progresit të përkushtimeve të bëra nga qeveritë në vitin 1995, gjatë Konferencës Botërore për Gratë në Pekin. Kjo është arsyeja, si dhe pse ky takim është quajtur “Pekini + 5”.

Pas çdo konference kryesore, lansohet *një instrument i planit për veprim*, i cili përmban një tërësi të masave dhe politikave, të cilat shtetet duhet t’i marrin në konsideratë për të arritur barazinë mes grave dhe burrave.



Platforma e Pekinit për Veprim, e miratuar në vitin 1995 gjatë Konferencës së Katërt Botërore të Kombeve të Bashkuara për Gratë, ka një rëndësi të posaçme. Preambula dhe 12 kapitujt e saj, përbëjnë programin më të plotë për të drejtat e grave, i cili përmban diagnozën mbi gjendjen e grave dhe ekzaminimin e politikave, strategjive dhe masave për promovimin e të drejtave të grave në gjithë botën. Vëmendje e posaçme u është kushtuar **12 fushave kryesore të shqetësimit**: varfërisë, arsimimit, konflikteve të armatosura, ekonomisë, procesit të vendimarrjes, mekanizmave institucionale, të drejtave të njeriut, mediave, mjedisit, fëmijëve vajza dhe rregullimit institucional dhe financiar.

Gratë dhe Varfëria

Në mënyrë që të kuptohet ndikimi i ndryshëm i varfërisë te gratë dhe burrat, është e domosdoshme të shikohet ndarja e pjesës më të madhe të tregut të punës në botë mbi bazt

gjinore. Shumë shpesh, edhe pse kontributet e grave janë të domosdoshme shoqërisht dhe ekonomikisht dhe do duhej të vlerësoheshin shumë lart, gratë punojnë në mirëmbajtjen e shtëpive, duke plotësuar obligimet e tyre për përkujdesjen ndaj fëmijëve, ndaj të sëmurve dhe të moshuarve, si dhe duke bërë punët e tyre të përditshme dhe për këtë nuk marrin kurrfarë kompensimi material, dhe gati askund nuk kanë sigurim të mirëfilltë.

Një ndër dimensionet e varfërisë që prekin gratë është ndarja e tregut të punës duke u bazuar në gjini. Funkzioni biologjik i maternitetit, paraqet një dimension tjetër strukturor, i cili kuptohet si funksion dhe përgjegjësi shoqërore e prindit.

☺☞ Moduli i Punës dhe Moduli i Varfërisë

>>Deri sa varfëria prek familjen në tërësi, si rezultat i ndarjes së punës dhe përgjegjësi për mirëqenien familjare në baza gjinore, gratë duke tentuar që nën kushte të shtimit të mungesës të bëjnë menaxhimin e konsumit dhe prodhimin familjar, e mbajnë barrën e shpërpjestuar.<<

PLATFORMA E PEKINIT PËR VEPRIM

Varfëria gjithashtu krijohet përmes pagesës jo të barabartë për punë të njëjtë dhe mohimit ose kufizimit të qasjes në arsimim ose shërbime publike e sociale, si dhe mohimit ose kufizimit të të drejtave trashëgimore dhe pronësisë së tokës.

Varfëria në dimensionin e saj politik, shfaq pabarazinë e të drejtave mes anëtarëve të shoqërisë tonë, gjë që u krijon atyre pengesë të madhe në qasje ndaj të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Varfëria gjithashtu zvogëlon qasjen ndaj informatave dhe ndaj mundësive për pjesëmarrje në organizata publike dhe procese të vendimmarrjes. Në kontekstin e migracionit, sidomos në Amerikën Latine, Azi dhe Evropë Juglindore, varfëria gjithashtu dërgon drejt shtimit të trafikimit të grave.

Statistikat për Kilin nga viti 1996 tregojnë se burrat realizojnë 67% të fitimit komercial dhe nuk bëjnë asnjë punë të shtëpisë, deri sa gratë realizojnë 37% të fitimit komercial dhe bëjnë 100% të punëve të shtëpisë. Kjo sasi e punës pa pagesë ndikon në reprodukim të shoqërisë dhe përfaqëson bazën strukturore të varfërisë, e cila i prek gratë.

ROSA BAVO (1998)

Gratë dhe shëndeti


Shëndeti i grave përfshin mirëqenien e tyre emocionale, sociale dhe fizike. Shëndeti i grave përcaktohet nga konteksti i jetës së tyre shoqërore, politike dhe ekonomike dhe nga biologjia. Reprodiktimi i shëndetit shikohet si një gjendje e plotë e mirëqenies fizike, mentale, shoqërore dhe shëndetit seksual, qëllimi i së cilës është përmirësimi i jetës dhe marrëdhënieve personale. Marrëdhëniet e barabarta mes grave dhe burrave në çështjet e marrëdhënieve seksuale dhe reprodukimit, kërkojnë respekt dhe pajtim të ndërsjellë, dhe gjithashtu edhe ndarje të përgjegjësive. Siç tregon edhe rasti i Filipineve, realiteti është tjetër:

Shkaku kryesor i vdekjes së grave të moshës reproduktive është shtatëzanësia dhe lindja e fëmijës. Gjakderdhja pas lindjes kryeson listën dhe pason nga çrregullimet hipertensive të shtatëzanësisë (pre-eklampsia dhe eklampsia). Njëra në gjashtë shtatëzanësi në Filipine përfundon me abort ilegal, pasi që, ose janë të paplanifikuara ose të padëshiruara. Llogaritet se çdo vit bëhen rreth 300.000 deri në 400.000 abortime ilegale, shumica prej të cilave përfundojnë me komplikime siç janë sepsa ose vdekja. Së paku 2 milion gra të martuara të moshës reproduktive dëshirojnë ta aplikojnë planifikimin familjar, por për shkaqe të ndryshme, përfshirë edhe mungesën e shërbimeve për planifikim familjar, ende nuk mund ta bëjnë këtë.

Llogaritet se 7 milion gra të moshës reproduktive, janë në rrezik të lartë për të mbetur shtatëzëna sepse janë: shumë të reja (nën moshën 18 vjeçare); kanë pasur katër ose më shumë shtatëzanësi; kanë përfunduar vonë shtatëzanësinë; ose janë vazhdimisht të sëmura . . . Edhe pse përballen me këtë rrezik, 2.6 milion e këtyre grave pritet të mbesin shtatëzëna çdo vit.

. . . shkalla e vdekshmërisë së nënave prej 172 vdekjeve në 100.000 lindje të shëndosha dhe shkalla vdekshmërisë së fëmijëve prej 32 vdekjeve në 1000 të lindur të gjallë . . . janë ndër më të lartat në botë.

DOMINI M. TOREVILLAS (2002)

 Moduli për Shëndetin.


>>24 gra nga Polonia, Rusia, Italia, Shqipëria dhe Turqia, janë liruar nga policia pas bastisjes së një shtëpie publike në Gjermani, ku ishin mbajtur si skllave dhe ishin detyruar në prostitucion. Dy gra ishin mbyllur për afërsisht për 7 muaj pa parë asnjëherë dritën. Një bandë prej 16 të dyshuarve nga Turqia, Italia dhe Shqipëria ishin arrestuar, kurse policia po kërkon edhe gjashtë të tjerë. Pretendohet se tre policë të Luedensheidit (Luedenscheid) kishin bashkëpunuar me rrjetin e trafikantëve. Ky operacion ishte ndër më të mëdhenjtë kundër një unaze të krimit të organizuar në Gjermani.<<

ERICH REIMANN (1996)

Gratë dhe Dhuna

Në shumë shoqëri gratë edhe vajzat i nënshtrohen dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike, të cilat si në jetën publike edhe në atë private ndërprejnë vijat e të ardhurave, klasës dhe kulturës. Gratë shpesh bëhen viktimat e dhunimit, abuzimit seksual, ngacmimit seksual dhe kërcënimit. Skllavëria seksuale, shtatëzanësia, prostitucioni i detyruar, sterilizimi, abortimi i detyruar, zgjedhja e parakohshme e gjinisë dhe vrasja e foshnjëve vajza, janë gjithashtu vepra të dhunës së kryer ndaj grave.

Aktet e tilla të dhunës shkelin, pengojnë ose pamundësojnë gratë të gëzojnë që të drejtat dhe liritë e tyre fundamentale. Prandaj miratimi i **Deklaratës për Eliminimin e Dhunës Ndaj Grave** me koncensus në vitin 1993, nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, si mjet për parandalimin e dhunës ndaj grave, është e një rëndësie të veçantë. Përveç kësaj, në vitin 1994 është emëruar **Raportuesi Special për Dhunë ndaj Grave**.

 Zbatimi dhe Monitorimi

Dhuna ndaj grave përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

- a) Dhunën fizike, seksuale dhe psikike që ndodhin në familje duke përfshirë rrahjen, abuzimin seksual të fëmijëve vajza në familje, dhunën e lidhur me pajën, dhunimin martesor, gjymtimin gjenital të femrave dhe praktikat tjera tradicionale që dëmtojnë gratë, si dhe dhunën jomartësore dhe dhunën e lidhur me shfrytëzim;
- b) Dhunën fizike, seksuale dhe psikike që ndodh brenda komunitetit të gjerë duke përfshirë dhunimin, abuzimin seksual, ngacmimin dhe kërcënimin seksual në vend

pune, institucione arsimore dhe gjetiu, si dhe trafikimin e grave dhe prostitucionin e detyruar;

c) Dhunën fizike, seksuale dhe psikike që kryhet nga shteti ose lejohet të ndodhë kudo.

Neni 2 i Deklaratës për Eliminimin e Dhunës Ndaj Grave

Përveç sistemit ekzistues ndërkombëtar, disa organizata regjionale i janë përkushtuar parandalimit ose çrrënjosjes së dhunës ndaj grave. Për shembull, sistemi Interamerikan i të drejtave të njeriut ofron mbrojtjen e grave përmes **Konventës Interamerikane për Parandalimin, Dënimin dhe Çrrënjosjen e Dhunës Ndaj Grave** të Belem do Paros (1995).

 Pjesa për Praktikën e Mira

Gratë dhe Konfliktet e Armatosura

Gratë gjatë luftës dhe konflikteve të armatosura shpesh bëhen viktimat e para të konfliktit të armatosur. Ruth Seifert në eseun e saj “Fronti i Dytë: Logjika e Dhunës Seksuale”, thekson se në shumë raste është strategji ushtarake që të goditen femrat për ta shkatërruar armikun. Sipas vendimit të Tribunalit Ndërkombëtar Penal të Ruandës, dhunimi i cili gjatë konflikteve të armatosura është i shpeshtë, paraqet një krim, i cili kur kryhet me qëllim të shkatërrimit të tërësishëm ose pjesërisht të një grupi, përbën edhe gjenocid. “Spastrimi Etnik” si strategji e luftës dhe dhunimi si një nga metodat e saj, duhet të goditen dhe nuk bën të lejohen të mbeten edhe më tutje nën hijen e pandëshkueshmërisë. Në statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale të vitit 1998, për herë të parë në histori, në mënyrë shprehimore krimet si dhunimi, shtatëzanësia e detyruar, prostitucioni i detyruar etj, janë inkuadruar dhe ofron një sistem që ka për qëllim që brenda jurisdiksioni të vet të sjellë drejtësi, si për viktimën ashtu edhe për kryesit e krimeve të tilla.

Gratë, rrallë luajnë rol aktiv në vendimet që shkaktojnë konfliktet e armatosura, por në vend të kësaj, gjatë konflikteve ato punojnë për ta ruajtur rendin shoqëror dhe bëjnë çdo gjë për të siguruar një jetë sa më normale. Ashtu siç thekson Qendra Ndërkombëtare për Hulimime të Grave në buletin e saj për rindërtimin e pasluftës, gratë shpesh “janë bartëse të ndarjes së shpërpjestuar të pasojave të luftës”. Shumë gra mbeten të veja dhe përballen me barrën e tepërt për mbajtjen e familjes, deri sa shpesh edhe vetë duhet të

përballen me trauma të shkaktuara gjatë luftës nga ekspozimi i tyre ndaj dhunës, e në veçanti ndaj dhunës seksuale. Në mënyrë që grave t'u ofrohet sa më shumë asistencë në plotësimin e nevojave të tyre të veçanta, sidomos gjatë misionëve të ardhshme paqëruajtëse, të gjithë këta faktorë duhet të merren në konsideratë më shumë.

>>Shumica e rasteve të dokumentuara kanë ndodhur nga vjeshta e vitit 1991 deri në fund të vitit 1993, me një përqendrim më të lartë mes muajve prillit - nëntor të vitit 1992. Megjithëse në Bosnjë dhe Hercegovinë janë raportuar dhunime si nga gratë myslimane, kroate dhe serbe, shumica e rasteve janë dhunime të grave myslimane nga burrat serbë. Kryesit e këtyre dhunimeve ishin ushtarë, grupe paramilitare, policë lokale dhe persona civilë. Numri i dhunimeve është i diskutueshëm. Një delegacion i Bashkimit Evropian ka sygjerruar një numër prej 20.000 dhunimeve; Ministri i Punëve të Jashtme të Bosnës ka thënë 50.000; Komisioni i Ekspertëve refuzoi të spekulojë për ndonjë numër.<<

CATHERINE N. NIARCHOS (1995)

Gratë dhe Resurset Natyrore

Fragmenti i Vandana Shivës, “Monokulturat, Monopolet, Mitet dhe Mashkullizimi i Agrikulturës” tregon se kur bëhet fjalë për ruajtjen e njohurive për resurset natyrore dhe mjedisin në Indi, gratë luajnë një rol të rëndësishëm. Sipas Vandana Shivës, “gjatë këtyre mileniumeve, gratë fermere kanë qenë ruajtëset dhe kultivueset e farërave.” Kjo nuk vlen vetëm për Indinë, por për gjithë botën. Përmes menaxhimit dhe përdorimit të resurseve natyrore, gratë u kanë siguruar mjete për jetesë familjeve dhe bashkësive të tyre.

Shkatërrimi i resurseve natyrore ka ndikim negativ në shëndetin, mirëqenien dhe kualitetin e jetës së popullsisë në tërësi, por që në veçanti prek gratë. Për më tepër, njohuritë, aftësitë dhe përvojat e tyre, rrallë merren në konsideratë nga vendimmarrësit, të cilët kryesisht janë meshkuj.

>>Fenomeni i biopiraterisë, përmes së cilës korporatat perëndimore po vjedhin njohuritë e mbledhura dhe zbulimet shekullore që kanë bërë gratë e botës së tretë është duke marrë përmasa epidemike. Kjo “biopirateri” tani është duke u justifikuar si një “partneritet” i ri mes agrobizneseve dhe grave të botës së tretë. Për ne, vjedhja nuk mund të jetë bazë e partneritetit.<<

VANDANA SHIVA (1998)

Fëmija Vajzë

Në shumë shtete, fëmijët vajza nga fazat më të hershme, gjatë fëmijërisë dhe në adoleshencë përballen me diskriminim. Në disa vende të botës, si rezultat i sjelljeve dhe praktikave të dëmshme siç janë, gjymtimi gjenital i femrave, preferenca për fëmijë meshkuj, martesat e hershme, eksploatimi seksual dhe praktikat e lidhura me shëndetësi dhe alokim të ushqimit, moshën e adoleshencës e arrijnë më pak vajzat sesa djemtë. Në ato shoqëri ku djemtë preferohen më shumë sesa vajzat, praktika e vrasjes së foshnjeve vajza është shumë e përhapur. Si rezultat i mungesës së ligjeve mbrojtëse, ose dështimit të zbatimit të ligjeve të tilla, vajzat janë më shumë të rrezikuara ndaj të gjitha llojeve të dhunës dhe në veçanti dhunës seksuale. Në shumë regjione të botës, vajzat përballen me diskriminim në qasjen e arsimimit dhe trajnimeve specializuese.

Shembull nga një gazetë e Indisë

Edhe në një incident tjetër të vrasjes së foshnjeve vajza, në një fshat të rajonit, si rezultat i helmimit nga prindërit dhe gjyshërit e saj, ka vdekur një vajzë e posalindur. Siç raportoi të shtunën Komesari i Policisë së Rajonit M. N. Manjunatha para gazetarëve, prindërit dhe gjyshërit janë arrestuar dhe sipas Nenit 302 të IPC-së (vrasja), ndaj tyre është filluar rasti. Ai theksoi se një zyrtar administrativ i fshatit Mollahalli Pudur ka parashtruar ankesë se javën e kaluar një Kavitha, pasi që i kishte lindur vajza e tretë me radhë, e kishte helmuar atë.

BURIMI:

[HTTP://NEWSARCHIVES.INDIAINFO.COM/2000/12/17/17FEMALE.HTML](http://NEWSARCHIVES.INDIAINFO.COM/2000/12/17/17FEMALE.HTML)



3. PERSPEKTIVAT NDËRKULTURORE DHE ÇËSHTJET

KONTRAVERSE

Koncepti i universalitetit është themelor për të drejtat e njeriut dhe kjo vlen në veçanti kur kemi të bëjmë me të drejtat e grave. Diversiteti kulturor është përdorur së tepërmi si asyetim ose pengesë për implementimin e plotë të të drejtave të grave. Dokumenti i miratuar në vitin 1993 gjatë Konferencës Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, është një arritje esenciale për gratë, pasi që nënvizon se:

“Të gjitha të drejtat e njeriut janë universale, të pandashme, recipocikisht të varura dhe të ndërlidhura . . . Deri sa rëndësia e karakteristikave kombëtare dhe regjionale si dhe veçoritë e ndryshme historike, kulturore dhe fetare duhet të merren parasysh, është obligim i shtetit, pa marrë parasysh sistemin e tij politik, ekonomik dhe kulturor, të promovojë dhe mbrojë të gjitha të drejtat dhe liritë fundamentale të njeriut.”

Me gjithë përhapjen e gjerë të konceptit të universalitetit, shumë sfera të jetës së përditshme të grave, edhe më tutje janë burime për kontraversa të shumta. Në disa religjione, gratë nuk gëzojnë trajtim të njëjtë me burrat. Në këto vende, mohimi i qasjes së barabartë në arsimim dhe mundësitë e punësimit, si dhe përjashtimi i hapur nga proceset politike të vendimmarrjes konsiderohen si normale. Në disa raste ekstreme politikave dhe qëndrimet e tilla paraqesin kërcënim për sigurinë personale të grave dhe të drejtën e tyre për jetë.

Në Nigeri gjatë vitit 2002, një grua e re nigeriane ishte dënuar sipas ligjit të Sheriatit me vdekje me goditje të gurëve. Sipas Amnesty International të Australisë, krimi për të cilin ishte pretenduar se e kishte kryer Amina Lawal, ishte lindja e fëmijës jashtë lidhjes martesore. Ky aktgjyjmë shkaktoi reagim të madh ndërkombëtar dhe parashtrioi pyetjen mbi pajtueshmërinë e disa praktikave kulturore dhe fetare me universalitetin e të drejtave të njeriut.


Një praktikë tjetër fetare që prek jetën e përditshme të grave mund të gjendet në Indi, ku me gjithë ndalimin në vitin 1892 nga qeveria britanike, tradita e hinduve e njohur si *suti* (*suttee*) ose *sati* për diegjen e të vejave së bashku me bashkëshortët e tyre të vdekur bazuar në rastin e fundit të regjistruar në Indi në vitin 2002, ende vazhdon të praktikohet.

Sot, **pjesëmarrja e gruas në politikë** është më e rëndësishme se kurrë, pasi që gratë më së miri mund t'i përmirësojnë problemet e tyre. Gjatë 50 viteve të fundit, grave gjithnjë e më shumë u janë dhënë të drejta për votim, kandidim dhe zgjedhje në pozita publike. Shpresohet se kjo do të rezultojë në më shumë politika të ndieshmërisë gjinore në mbarë botën. 🗳️ Moduli për Demokraci

>>Pjesëmarrja e grave në politikë nuk mund të shikohet më vetëm si një shërbim ofruar grave nga institucionet ende të dominuara nga burrat, por si një përgjegjësi dhe obligim për të krijuar një botë më të barabartë dhe më demokratike.<<

**BENGT SÄVE-SÖDERBERGH, SEKRETARI GJENERAL I IDESË
NDËRKOMBËTARE.**

Që nga rrëzimi i komunizmit, gratë e shteteve postkomuniste të cilat kanë kualifikimet e njëjta me kolegët e tyre meshkuj, për punën e njëjtë fitojnë shpërblim më të vogël për 1/3 e shumës së përgjithshme. Brenda Bashkimit Evropian (EU), Neni 141 i Marrëveshjes për Themelimin e Bashkimit Evropian kërkon pagesë të njëjtë për gratë dhe burrat që bëjnë punë të njëjtë dhe kanë kualifikime të njëjta. Sidoqoftë, në realitet, shumë shtete anëtare të BE janë larg përmbushjes së plotë të kërkesës për **pagesë të njëjtë midis grave dhe burrave për punën e njëjtë.**

 Moduli për Punën

Po ashtu, zakonet dhe traditat paraqiten si burim i rrezikut për fëmijët vajza dhe vajzat tinxhere.

Për shembull, **Gjymtimi Gjenital i Femrave (FGM)**, është bërë përafërsisht te 135 milion gra dhe vajza të botës. Për më tepër, sipas Amnesty International, çdo vit dy milion vajza gjenden në rrezik nga gjymtimi, që do të thotë se përafërsisht çdo ditë 6000 vajza përballen me rrezik nga gjymtimi gjenital. Disa pjesë të Afrikës dhe Lindja e Mesme janë vendet kryesore ku praktikohet FGM-ja. Bashkësitë e imigrantëve kanë sjellë FGM-në edhe në disa pjesë të Azisë, Pacifikut, Amerikës Veriore dhe Latine dhe në Evropë.

Tradita e **martesës së fëmijëve**, gjithashtu ka shkaktuar probleme shëndetësore për fëmijët vajza. Sipas dokumenteve të organizatës joqeveritare Komiteti për UNICEF, lidhur me problemet shëndetësore të fëmijët vajza, më së shumti në Azi martesat e hershme pashmangshëm rezultojnë në shtatëzanësi të hershme që shkaktojnë “vdekshmërinë e nënave të vajzat e moshës 10 -14 vjeçare pesë herë më shumë se sa të gratë e moshës 20-24”. OJQ-ja Komiteti për UNICEF, gjithashtu ofron shënime për HIV/AIDS-in, që tregojnë se fëmijët vajza janë në rrezik të lartë nga infektimi me virus,

qoftë përmes nënave të tyre, ose nga dhuna seksuale, për shkak të dhunimit, që mund të kryhet ndaj tyre.

4. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Për zbatimin e plotë të drejtave të grave, nevojiten përpjekje të veçanta për reinterpretimin e një numri të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e mekanizmave të reja për sigurimin e barazisë gjinore.

Sa i përket **zbatimit të drejtave të grave**, ekzistojnë pikëpamje të ndryshme të cilat do të mund të respektohen, jo vetëm nga qeveritë, por gjithashtu edhe nga shoqëria civile.

- E rëndësishme parësore është që përmes sistemit të shkollimit formal ose joformal për **arsimim mbi të drejtat e njeriut** të bëhet përhapja e instrumenteve dhe mekanizmave për të drejtat e grave. Nëse gratë nuk i dijnë të drejtat e tyre, nuk ka gjasë që ato t'i ushtrojnë këto të drejta.
- **Përkrahja e grave për të bërë monitorimin e veprimeve të shtetit të tyre** është një hap tjetër i rëndësishëm për të parë se a janë duke i përmbushur shtetet obligimet e tyre që gjenden në instrumentet ndërkombëtare, të cilat i kanë ratifikuar. Nëse obligimet shtetërore nuk janë përmbushur në mënyrë të rregullt, atëherë OJQ-të mund të përgatisin raporte alternative ose “paralele” për komitete përkatëse. Gratë duhet të inkurajohen që të përgatisin raporte alternative CEDAW-it, si dhe komiteteve ose organeve të tjera të parapara me konventa. Raportet paralele u mundësojnë pjesëtarëve të shoqërisë civile t'i konsiderojnë qeveritë e tyre të përgjegjshme ndaj obligimeve dhe përkushtimeve që kanë marrë në nivel ndërkombëtar. Përveç kësaj, ato kontribuojnë për ngritjen e vetëdijes në vendin e tyre, lidhur me procesin e raportimit në CEDAW.
- Në ato vende ku **Protokoli Opcional i CEDAW-it** nuk është ratifikuar ende, duhet të organizohen fushata lobimi për ratifikimin e tij sa më të shpejtë. Ratifikimi i këtij Protokoli Opcional nënkupton që shteti ratifikues e njeh kompetencën e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Ndaj Grave për të **pranuar dhe shqyrtuar ankesat e individëve ose grupeve**, brenda jurisdiksionit të shteteve përkatëse. Komiteti gjithashtu monitoron pajtueshmërinë e shteteve anëtare me obligimet e marra me CEDAW.

- Një hap i rëndësishëm në drejtim të implementimit të plotë të instrumenteve për të drejta të grave është edhe **trajnimi i femrave avokate për përdorimin e mekanizmave për të drejtat e njeriut**. Për momentin, shumë pak gra kanë njohuri për instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ndërsa edhe më pak i dijnë mënyrat e drejta për përdorimin e atyre instrumenteve.



Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut e mbajtur në vitin 1993 në Vjenë, përkrahu krijimin e **Raportuesit Special për Dhunë ndaj Grave** si një mekanizëm i ri. Zonja Radhika Coomaraswamy nga Shri Lanka, ka kryer këtë detyrë që nga viti 1994. Si pjesë e detyrës së saj, ajo viziton vendet e ndryshme dhe ekzaminon nivelin e dhunës ndaj grave atje, por gjithashtu me qëllim të krijimit të pajtimit të praktikave të tyre me normat ligjore ndërkombëtare në fushën e të drejtave të grave, bën edhe rekomandime.

Me gjithë përmirësimet e dukshme që janë bërë në fushën e të drejtave të grave gjatë 30 viteve të fundit, paraqitja e mendimeve ultrakonservative dhe fundamentaliste në shumë shoqëri, ka qenë një hap prapa për të drejtat e grave, prandaj, pa marrë parasysh koston, është shumë e rëndësishme që vazhdimisht të theksohet kërkesa për implemetimin e plotë të drejtave të grave.



E DOBISHME TË DIHET

1. PRAKTIKA TË MIRA

Gjatë viteve të fundit, organizatat joqeveritare dhe qeveritare janë angazhuar në procesin e vështirë të hartimit të dispozitave të obligueshme ligjore për sigurimin e të drejtave të grave, si dhe në projekte me vlerë të lartë praktike për realizimin e qëllimeve të standardeve të zhvilluara.

Tashmë ka filluar procesi i **interpretimit** të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga një aspekt më i madh i ndieshmërisë gjinore. Një nga shembujt më të mirë është mirtimi i Komentit të Përgjithshëm 28, nga Komitetit i OKB-së për të Drejtat e Njeriut në mars të vitit 2000. Duke bërë Komiteti interpretimin e Nenit 3 të ICCPR-së (Paktit Ndërkombëtar për të të Drejtat Civile dhe Politike) për të drejtën e barabartë të

burrave dhe grave në gëzimin e të gjitha të drejtave civile dhe politike, ai rishikoi të gjitha nenet e paktit përmes thjerrëzës së ndieshmërisë gjinore.

Më 1992, **CLADEM**-i së bashku me Komitetin Amerikano-Latin dhe Karaibik për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave, duke përfshirë organizata nga e gjithë bota filloi një fushatë, e cila rezultoi me draftimin e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut me Perspektivë Gjinore. Kjo Deklaratë tani përdoret si deklaratë “paralele” për qëllime arsimuese. Qëllimi i saj është që gratë, jo vetëm të inkurajohen të mësojnë për të drejtat e njeriut, por që në kuadër të kësaj kornize dhe gjuhës së tyre t’i inkuadrojnë edhe përvojat personale, kërkesat si dhe dëshirat e tyre.

Miratimi i **Konventës Interamerikane për Prandalimin, Dënimin dhe Çrrenjosjen e Dhunës ndaj Grave**, në vitin 1995 në **Belém do Pará** të Brazilit, paraqet një ndër momentet më të rëndësishme në histori të kushtimit të vëmendjes ndaj të drejtave të grave në kuadër të sistemit të drejtave të njeriut. Kjo Konventë është përgatitur nga Komisioni Interamerikan i Grave, gjatë një procesi pesëvjeçar. Konventa është miratuar pothuaj në të gjitha vendet e rajonit dhe paraqet një kornizë politike dhe ligjore të një strategjie, e cila duke bërë të obligueshëm implementimin e strategjive publike për parandalimin e dhunës dhe ndihmën e viktimave për shtete, do të trajtojë problemin e dhunës.



Në kuadër të strukturës së **Komisionit Afrikan për të Drejtat e Njerëzve dhe Popujve**, është hartur një “*Protokol Shtesë për të Drejtat e Grave*” si hap pozitiv drejt leximit të Kartës më nga një prspektivë më e madhe e ndieshmërisë gjinore. Sidoqoftë, ajo ende nuk është miratuar nga **Unioni Afrikan (AU)**.

Përmes fillimit të **Pasaportës së Dinjitetit** dhe serialit **Gratë mbajnë Qiellin, Lëvizja Popullore për Arsimim në të Drejtat e Njeriut (PDHRE)** ka bërë një kontribut të rëndësishëm për avancimin e të drejtave të grave. Pasaporta e Dinjitetit përmes shqyrtimit global të 12 fushave kryesore të shqetësimit nga Platforma e Pekinit për Veprim dhe duke u bazuar në raporte të ekspertëve, si dhe në informata të dorës së parë nga gratë, krijon një raport mes obligimeve ligjore dhe realitet në shumë shtete. Me përkrahjen e Institutit

të Vjenës për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Departamentit për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austrisë, në vitin 1999 me rastin e festimit të 20 vjetorit të CEDAW-it, është botuar manual tjetër “**Në mesin e tregimeve të tyre dhe realitetit tonë**”, si pjesë integrale e serialit të lartpërmendur, **gratë mbajnë qiellin**. Me këtë kontribut të çmuar, Lëvizja Popullore për Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut, ofroi material të çmueshëm për trajnimin e brezave të ardhshëm të aktivistëve për të drejtat e grave.

Organizata joqeveritare gjermane “**Terre des Femmes**”, gjatë vitit 2000 organizoi një fushatë kundër trafikimit të grave dhe përkrahu projektin Malinkowa të Minskut, nga Bëlorusia, i cili informon dhe ua tërheq vërejtjen grave për ekzistimin e kërcënimit për trafikim, abuzim seksual dhe prostitucion të detyruar. Fushata e tyre e fundit përqendohet në ndalimin e martesave të imponuara dhe luftimin e dhunës ndaj grave.

>>Në këtë çast të rëndësishëm dëshiroj t’u bëj nderim grave të Takimit të Grave për Drejtësi Gjnore, të cilat kanë mësuar përvojën e grave që kanë përjetuar luftën, identifikuan strategjitë për trajtimin e dhunës dhe tejkaluan kundërshtimin e fuqishëm të shumë përfaqësuesve gjatë negociatave për Gjykatën Ndërkombëtare Penale (ICC) dhe ia arritën të sigurojnë që dhunimi, skllavërimi seksual, shtatëzanësia e detyruar dhe format e tjera të dhunës seksuale të bazara në gjini, të përfshihen në statutin e ICC-së<<.

MARY ROBINSON, ISH-KOMESARE E LARTË E OKB-SË PËR TË DREJTAT E NJERIUT

2. TRENDET

Gjatë dekadës së fundit, **OJQ-të e grave** janë involvuar aktivisht në një numër të çështjeve të lidhura me të drejtat e njeriut dhe të drejtën humanitare. Në Konferencën e Romës të vitit 1998, gjatë draftimit të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për të siguruar që draftuesit do t’i merrnin seriozisht në konsiderim të drejtat e grave dhe do t’i inkorporonin ato në statut, në konferencë mori pjesë edhe një grup i grave. *Gratë kuptuan se pa një organizim të mirë, shqetësimet e grave nuk do të promovoheshin dhe*

mbroreshin në mënyrë të drejtë. Duke gjykuar nga Statuti i Romës, i cili ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2002, ato patën sukses.

Statuti i **Gjykatës Ndërkombëtare Penale** i vitit 1998, paraqet një etapë të re historike për të drejtën ndërkombëtare humanitare. Zhvillimet në hapësirat e Ish-Jugosllavisë dhe Ruandës kanë treguar se mbrojtja e grave dhe e të drejtave e tyre duhet të bëhen pjesë e një Gjykate Ndërkombëtare Penale. Deri më 10 prill të vitit 2003, Statutin e Romës e kanë nënshkruar dhe i janë aderuar 139 shtete, deri sa 89 shtete tanimë e kanë ratifikuar.

Statuti i Romës për herë të parë në histori përmend në formë eksplicite krimet e ndryshme që kryhen ndaj grave e që ndëshkohen me statut. Për shembull, Neni 7 (1) thekson se dhunimi, skllavërimi seksual, prostitucioni dhe shtatëzanësia e detyruar, sterilizimi i detyruar, ose çfarëdo forme tjetër e dhunës seksuale të rrezikshmërisë së krahasueshme, përbëjnë krimet kundër njerëzimit. Për më tepër, vëmendje e veçantë u është kushtuar viktimave dhe dëshmitarëve. Neni 68 i Statutit, thekson se do të sigurohet *“siguria, mirëqenia fizike dhe psikike, dinjiteti dhe privatësia e viktimave dhe dëshmitarëve”* dhe se organi gjyqësor mund të urdhërojë *“zhvillimin e çdo pjese të procedurës përmes kamerave, ose do të lejojë prezentimin e provave përmes mjeteve elektronike dhe mjeteve të tjera të veçanta. Në veçanti, këto masa duhet të aplikohen në rastin e viktimave të dhunës sekuale, ose në rastet kur fëmija është ose viktimë ose dëshmitar . . .”*këto masa mbrojtëse janë gjithashtu rezultat i përvojës së fituar gjatë gjykimeve të mbajtura në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për Jugosllavi (ICTY) ose Gjykatën Penale Ndërkombëtare për Ruandë (ICTR).

BURIMI: [HTTP://WWW.ICCNOW.ORG](http://www.iccnw.org)

Lëvizjet e grave kanë arritur që gjithashtu me sukses të promovojnë të drejtat e grave në nivel kombëtar. Në **Ugandë**, gratë deputete lobuan për një ligj të ri mbi tokën, i cili do t'u lejonte grave të trashëgojnë tokën nga bashkëshortët e tyre të vdekur. Zakonet e kanë ndaluar këtë për një kohë të gjatë. Përfundimisht ato patën sukses, dhe tani shumë gra e kuptojnë se kanë të drejtë për tokën e cila u nevojitet për të mbajtur veten. Ky sukses i inkurajoi gratë që të merren edhe me probleme të tjera të rëndësishme, siç është ligji për

Marrëdhënie Familjare, i cili ka për qëllim të ndalojë disa dukuri siç janë poligamia ose rrahja e gruas.

BURIMI: [HTTP://WWW.ONEWORLD.ORG/IPS/SEPT98/17_03_046.HTML](http://www.oneworld.org/ips/sept98/17_03_046.html)

3. KRONOLOGJIA

- 1789** Deklarata për të Drejtat e Gruas dhe Qytetares Femër nga Olimpe de Guzh (Olympe de Gouges)
- 1888** Themelimi i Këshillit Ndërkombëtar të Grave
- 1921** Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Trafikimit të Grave dhe Fëmijëve dhe Protokoli Shtesë
- 1933** Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Trafikimit të Grave të moshës madhore
- 1950** Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Trafikimit të Personave dhe Eksploatimit të tjerëve përmes Prostitucionit
- 1953** Konventa për të Drejtat Politike të Grave
- 1957** Konventa për Shtetësinë e Grave të martuara
- 1962** Konventa për Pajtim në Martesë, Moshën Minimale për Martesë dhe Regjistrimin e Martesave
- 1967** Deklarata për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
- 1975** Konferenca e parë Botërore e Kombeve të Bashkura për Gratë (Meksiko Siti)
- 1976** Fillimi i Dekadës së OKB-së për Gratë: Barazia, Zhvillimi dhe Paqja
- 1979** Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)
- 1980** Konferenca e dytë Botërore e Kombeve të Bashkura për Gratë (Kopenhagë)
- 1985** Konferenca e tretë Botërore e Kombeve të Bashkura për Gratë (Nairobi)
- 1985** Miratimi i Strategjive të Nairobit të Parapara për Avancimin e Grave deri në vitin 2000
- 1995** Konferenca e katërt Botërore e Kombeve të Bashkura për Gratë (Pekin)
- 1998** Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale
- 2000** Protokoli për Parandalimin, Ndalimin dhe Dënimin e Trafikimit të Personave, në veçanti të Grave dhe Fëmijëve, si plotësim i Konventës së OKB-së kundër Krimin të Organizuar Transnacional

2000 Takimi i 23 të Special i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, “Gratë 2000: Barazia Gjinore, Zhvillimi dhe Paqja në shekullin XXI”

AKTIVITETE TË PËRZGJEDHURA



1

AKTIVITETI I: PARAFRAZIMI I CEDAW-IT

PJESA 1: HYRJE

Ky aktivitet ka qëllim përmirësojë të kuptuarit e Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe në veçanti është paraparë për laik (jo avokat), të cilët nuk e njohin terminologjinë juridike.

Forma e aktivitetit: ushtrim

PJESA II: INFORMATA TË PËRGGJITHSHME PËR AKTIVITETIN

Qëllimet dhe Synimet:

- Ngritja e vetëdijes për të drejtat e grave.
- Familjarizimi me terminologjinë juridike.
- Shqyrtimi i qëndrimeve të ndryshme për të drejtat e grave.
- Diskutimi për instrumentet ligjore që trajtojnë të drejtat e grave.

Grupi i synuar: Të rriturit e rinj dhe të rriturit

Madhësia e grupit/organizimi shoqëror: 20 – 25 njerëz

Kohëzgjatja: afërsisht 60 minuta.

Materiali: Kopje të CEDAW-it, letër dhe lapsa.

Aftësitë e përfshira:

Leximi dhe parafrazimi i terminologjisë juridike, komunikimi, bashkëpunimi dhe vlerësimi i qëndrimeve të ndryshme.

PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR AKTIVITETIN

Përshkrimi i aktivitetit/ Instruksionet

Pas zhvillimit të një prezantimi hyrës për CEDAW-in, moderatori duhet t'i lusë pjesëmarrësit që të ndahen në 4-5 grupe. Secilit grup i caktohet një pjesë e caktuar e CEDAW-it për ta përkthyer në gjuhën e përditshme, pra LAIKE (JOLIGJORE).

Gjithashtu, është e mundur që një dispozitë ose dispozitat e njëjta t'u caktohen të gjitha grupeve, gjë që do të bënte diskutimet e hollësishme më interesante, pasi që njerëzit e ndryshëm mund t'i shohin disa shprehje ndryshe nga tjerët.

Pasi që rezultatet e “përkthimit” u paraqiten të gjithëve, grupi duhet të shohë gjendjen në vendin e tyre. Diskutimi i gjitha ose disa pyetjeve që pasojnë, mund të jenë të dobishme për vlerësimin e asaj që çfarë duhet të ndryshohet:

- A përcaktohen të drejtat e grave ndaras prej të drejtave të njeriut në shoqërinë tuaj? Si bëhet ky segregacion: me ligj? me zakone?
- A është i hapur segregacioni? Apo është “realitet jetësor” për të cilin nuk flet askush?
- A i përfshin të gjitha gratë? Nëse jo, cilat gra janë më të prekurat?
- Përshkruaj një shembull konkret të segregacionit gjinor?
- Si përgjigjen gratë ndaj këtij segregacioni?
- A ekzistojnë të drejta të caktuara që burrat i gëzojnë pa problem, kurse gratë duhet të bëjnë përpjekje të veçanta për t'iu njohur të drejtat e njëjta?
- A ekzistojnë fusha të jetës ku gratë duhet të veprojnë përmes ndërmjetësimit të burrave? Cilat janë pengesat e autonomisë së grave?
- Çka thotë kushtetuta e vendit tuaj për të drejtat e grave? A ka mospajtim mes realitetit jetësor dhe parimeve të kushtetutës?
- A dini për ndonjë rast konkret që është duke u zhvilluar në gjyq lidhur me të drejtat e grave? Për çka bëhet fjalë? Cilat të drejta janë shkelur?
- A kanë në përgjithësi avokatët njohuri për CEDAW-in dhe instrumentet e tjera ligjore për të drejtat e grave?

Këshilla praktike

Puna në grupe prej 4-5 prsonave, mundëson diskutim më intensiv, kurse pjesëmarrësve të qetë dhe të pasigurt u jep rast më të madh për t'u përfshirë. Sidoqoftë, rezultatet e punës së grupit gjithmonë duhet të prezantohen dhe diskutohen pranë të gjithëve, në mënyrë që të sigurohet niveli i njëjtë i njohurisë për të gjithë pjesëmarrësit.

Sygerime për ndryshim

Varësisht prej interesit të pjesëmarrësve dhe temës së kursit, ky aktivitet mund të zhvillohet me çfarëdo lloj dokumenti ligjor.

PJESA IV: VAZHDMI

Një vazhdimi i përshtatshëm do të ishte organizimi i një fushate për të drejtat e grave.

Të drejtat e ngjashme/ fushat e tjera të hulumtimit

Të drejtat e njeriut, të drejtat e minoriteteve



2

AKTIVITETI II: GJUHA E SHENJAVE, E GRAVE DHE BURRAVE

PJESA I: HYRJE

“Ajo që thuhet përbën 10% të porosisë – kurse mënyra se si thuhet 90%”. Shumë njerëz nuk janë të vetëdijshëm sa gjuha e shenjave ndikon në paraqitje dhe komunikim, ndërsa edhe më pak janë të vetëdijshëm që gratë dhe burrat veprojnë ndryshe, jo vetëm me fjalë por edhe me gjeste dhe lëvizje.

Forma e aktivitetit: një ushtrim/ luajtje e roleve

PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR AKTIVITETIN

Qëllimet dhe Synimet:

- Sensibilizimi për komunikim
- Përkrahja e identifikimit të rasteve me veten
- Kuptimi i roleve gjinore

Grupi i synuar: Të rriturit e rinj dhe të rriturit; djemtë dhe vajzat nga mosha 12 vjeçare

Madhësia e grupit/organizimi shoqëror: 20 – 25 njerëz; puna në grupe të vogla dhe çifte dhe puna e përbashkët

Kohëzgjatja: afërsisht 60 minuta.

Përgatitja: Duhet pasur kujdes që pjesëmarrësit të kenë hapësirë të mjaftueshme për të lëvizur.

Aftësitë e përfshira: Aftësi kreative, aktrim

PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE PËR AKTIVITETIN

Përshkrimi i aktivitetit/ Instuksionet

Së pari, pjesëmarrëset femra mësojnë gjuhën e shenjave që është tipike për femra, pastaj edhe meshkujt, gjuhën e shenjave tipike mashkullore. Kjo përfshin pozitat tipike gjatë ecjes, uljes ose gjatë bisedës me të tjerët, gjatë situatave të ndryshme. Pjesëmarrësit nuk duhet të flasin vetëm për gjuhën e shenjave, por të provojnë edhe gjestikulacione dhe pozicione të ndryshme.

Më pas, moderatori duhet t'iu tregojë pjesëmarrësve sjelljet specifike gjinore dhe gjuhën e shenjave gjatë situatave të ndryshme (p.sh. me vizatime ose fotografi). Pjesëmarrësit duhet të mundohen të imitojnë pozicionet e paraqitura dhe të mendojnë se si ndihen gjatë pozicionit të caktuar.

Pas këtij ushtrimi fillestar, grupi duhet të ndahet në çifte, preferohet në çifte të përziera dhe të përpunojnë njërën nga skenat e dhëna më poshtë, që pastaj i prezantohen grupit:

- Babai është hidhëruar në vajzën e cila është kthyer vonë në shtëpi.
- Një djalë i ri mundohet të hyjë në bisedë me një grua në rrugë.
- Një vajzë e re në një kompani e lut një koleg mashkull për ndihmë, pasi që ajo nuk di shumë për kompaninë.
- Një çift i ri ha darkë në restorant. Ata bëjnë pagesën dhe shkojnë.

Këto shfaqje të vogla duhet të bëhen para audiencës. Pastaj, një diskutim i mundshëm mund të bëhet për efektin e gjuhës së shenjave, p.sh. si reagon shoqëria kur një burrë fillon të sillet si një femër dhe e kundërta.

Këshilla praktike

Do të ishte përvojë shumë interesante për pjesëmarrësit t'iu ndërrojnë rolet femër/mashkull, por kjo me siguri do të shkatëronte shumë vështirë për pjesëmarrësit që vijnë nga kulturat ku rolet e gjinive janë shumë strikte dhe dallojnë shumë mes vete. Pra, mbetet për moderatorin të vendosë se çka mund të presë, pa hasur në rrezikun e “rebelimit”.

PJESA IV: VAZHDIMI

Një vazhdimi i përshtatshëm do të ishte për shembull analizimi i sjelljes së grave dhe burrave në një debat ose film artistik.

Të drejtat e ngjashme/ fushat e tjera të hulumtimit

Të drejtat e njeriut në përgjithësi, të drejtat e minoriteteve

BIBLIOGRAFIA

Abiella, Rosalie. 1987. *The Evolutionary Nature of Equality.* in: Mahoney, Kathleen and Sheilah Martin. *Equality and Judicial Neutrality.* Toronto: Carswell.

Achieng, Judith. 1998. *RIGHTS-UGANDA: Women benefit from new Land Legislation.* available online at: http://www.oneworld.org/ips2/sept98/17_03_045.html

Amnesty Interational Australia. *Defending women's rights. Nigeria: Condemnation of the death penalty. Concerns on the implementation of new Sharia-based penal codes.* available online at: <http://www.amnesty.org.au/women/action-ltter09.html>

Amnesty International. *Female Gender Mutiliation – A Human Rights Information Pack.* available online at: <http://www.amnesty.org/ailib/intcam/femgen/fgm1.htm>
Another girl chiled killed in Tamil Nadu. available online at:
<http://www.newsarchives.indiainfo.com/2000/12/17/17female.html>

Benedek, Wolfgang and Gerd Oberleitner, Esther Kisaakye(eds.). 2002. *Human Rights of Women: International Instruments and African Experiences.* London: Zed Books.

Boletín Red Feminista Latinoamerica y del Caribe contra la violencia domestica y sexual. Isis, No.20. July/Septemer 1998.

Bravo, Rosa. 1998. *Pobreza por razones de Género y Pobreza, Nuevas dimensiones.* Santiago de Chile: Editores Isis.

Cook, Rebeca. 1994. *State Accauntability under Eomen's Convention.* in: *Human Rights of Women.* University of Pennsylvania.

ECLAC Women and Development Unit. 2000. *The challenge of gender equity and human rights on the threshold of the tēenty-first century.* Santiago.

Emily Davison. Available online at: <http://www.spartacus.schoolnet.co.uk/Wdavison.htm>

Falcón O'Neil, Lidia. 1999. *Historia de los Derechos de las Mujeres. La construcción del Sujeto Político*. Seminario Internacional de Derechos Humanos. Movimiento Manuela Ramos. Lima.

Inter-American Commission on Human Rights – Organization of American States. Report No.54/01, Case 12.051, *Maria da Penha Maia Fernandes –Brazil*, 16 April 2001. available online at:

<http://www.cidh.oas.org/annualrep/2000eng/ChapterIII/Merits/Brazil12.051.htm>

International Center for Research on Women. 1988. *Information Bulletin: After the Peace: Women in Post-Conflict Reconstruction*. available online at:

<http://www.icrw.org/docs/postconflictinfobulletin.pdf>

Kamat, Jyostna. *The tradition of Sati in India*. available online at:

<http://www.kamat.com/kalranga/hindu/sati.htm>

Karam, Azza. 1998. *Beyond Token Representation*, in: *Women in Parliament: Beyond Numbers*. available online on: <http://www.idea.int/women/parl/toc.htm>

Koenig, Shulamith. 1998. *Embracing Women as Full Owners of Human Rights*, in: Haxton, Eva and Claes Olsson (eds.), *Gender Focus on the WTO*. Uppsala: ICDA.

Moller Okin, Susan. 1998. *Justice, Gender and the family*, New York: Basic Books.

Neuhold, Brita and Brigit Henökl. 2000. *Women's Rights – Human Rights: From Dream to Reality*. Vienna: Austria Service for Development Co-Operation.

NGO Committee on UNICEF. *Factsheet: Girl Child Health Issues*. available online at: <http://www.girlrights.org/factsheet/health.pdf>

NGO Committee on UNICEF. *Factsheet: Girl Child Health Issues*. available online at: <http://www.girlrights.org/factsheet/hivfactsheet.pdf>

Niarchos, Catherine M. 1995. *Women, War, and Rape: Challenges Facing The International Tribunal for the Former Yugoslavia.* *Human Rights Quarterly* 7.4 (1995) 649-690. available online at:

http://muse.jhu.edu/demo/human_rights_quarterly/17.4naiarchos.html#Rape

Pandjarian, Valeria. 2003. *Investigating and Analyzing a Strategy*, in: *Women, Law and Development International*. Saõ Paulo: Cladem Brazil.

People's Decade for Human Rights Education. 2002. *Women Hold up the Sky.* New York.

People's Decade for Human Rights Education. 1999. *Between their Stories and our Realities.* New York.

Power, Carla. 2002. *The Shackles of Freedom. The end of communism was supposed to make life better for women. Has it?* *Newsweek International*, 18 March 2002. available online at: <http://www.cdi.org/russia/johnson/6142-2.cfm>

Reimann, Erich. 1996. *German Breaks Up Sex Slave Ring*, Associated Press, 13 December 1996. available online at: <http://www.catwinternational.org/fb/Germany.html>

Resolution A/Res/48/104, 20 December 1993. *Declaration on the Elimination of Violence against Women.*

Seifer, Ruth. 1996. "The Second Front: The Logic of Sexual Violence in Wars" in: *Women's Studies International Forum* 19 (1/2) 1996, 35-43.

Shanti, Dairian. 1998. *Equality and the Structures of Discrimination.* in: Yaeli, Danieli and Elsa Stamatopoulou, Clarence Dias (eds.). New York.

Shiva, Vandana. 1998. *Monocultures, Monopolies, Myths and the Masculinisation of Agriculture*, <http://gos.sbc.edu/s/shiva2html>

The Prosecutor vs. Jean-Paul Akayesu. ICTR-96-4, 2 September 1998.

The Vienna Declaration and Programme of Action. 1993.

Torrevillas, Domini M. 2002. *Why I am for House Bill 4110*, The Philippine Star, August 29, 2002. available online at:

http://www.remedios.com.ph/fhtml/mk4q2002_wiaf.htm

United Nations. 2001. *Multilateral Treaty Framework: An Invitation to Universal Participation, Focus 2001: Rights of Women and Children.*

United Nations. 2000. *Women, Peace and Security*, Study submitted by the Secretary-General pursuant to Security Council resolution 1325 (2000).

INFORMATATA PLOTËSUESE

Campaign for a Latin American and Caribbean Convention in Sexual Rights and Reproductive Rights: www.convencion.org.uy

CLADEM – Latin American and Caribbean Committee for the Defense of Women Rights: www.cladem.org (in English, Portuguese and Spanish).

Economic Commission for Latin America and the Caribbean: <http://www.eclac.org>

International Council of Women: <http://www.icw-cif.org>

Terre des Femmes – Menschenrechte für die Frau e.V.:

<http://www.terresdesfemese.de>

Organization of American States: <http://www.oas.org>

People's Movement for Human Rights Education: <http://www.pdhre.org>

RSMLAC – Latin American Women's Health Network: <http://rsmlac.org>

United Nations: Commission on the Status of Women:

<http://www.undp.org/fwcw/csw>

United Nations: Committee on the Elimination of Discrimination against Women:

<http://www.un.org/DPCSD/daw/cedaw>

United Nations: Division for the Advancement of Women:

<http://www.un.org/DPCSD/daw>